



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2022:034206
Datë: 12.12.2023
Numri i dokumentit: 05051410

C.nr.129/2022

Gjykata Themelore në Pejë, Dega në Deçan, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Bajram Cacaj, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A.XH, nga Komuna e Deçanit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson F.K, avokat në Pejë, kundër të paditurës Komunës së Deçanit, Drejtoria e Arsimit, me seli në Deçan, me objekt kontesti kompensim mbi bazë e kualifikimit, me vlerë të pa përcaktuar, jashtë seance më datë 12 dhjetor 2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET së është tërhequr padia me numër C.nr.129/2022, e datës 21.02.2022 e paditëses A.XH, kundër të paditurës Komuna e Deçanit, Drejtoria e Arsimit, lidhur me çështjen e kompensimit mbi bazë e kualifikimit.

A r s y e t i m

Paditësja A.XH, nga Komuna e Deçanit, përmes përfaqësuesit me autorizim ka ushtruar padi në këtë gjykatë, kundër të paditurës Komuna e Deçanit, Drejtoria e Arsimit, për kompensim mbi bazën e kualifikimit.

I autorizuari i paditëses me parashtresën e datës 6 dhjetor 2023, e kanë njoftuar gjykatën se për arsye se është dorëzuar dy herë e njëjta padi për kontestin e njëjtë, e tërheq padinë ndaj të paditurës Komuna e Deçanit, Drejtoria Komonale e Arsimit, me bazë të kontestit kompensim mbi bazën e kualifikimit.

Gjykata e vlerësoj faktin nëse në këtë gjykatë janë të ushtruar dy padi për të njëjtën çështje dhe gjeti se qëndron fakti i tillë ngase në këtë gjykatë me datë 21.06.2021 është pranuar padia e cila evidentohet sipas numrit C.nr.435/21 dhe numër të dosjes në SMIL 2021:134522, e cila padi po ashtu është parashtruar nga paditësja e njëjtë, ndaj të paditurit të njëjtë dhe ka të njëjtën çështje

për objekt të kontestit, andaj gjykata veprimi në raport me parashtrësën e paraqitur dhe konstatoi se padia është tërhequr.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 e lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË

Dega në Deçan

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.129/2022, datë 12.12.2023

Gjyqtari

Bajram Cacaj

KËSHILLË JURDIKE:

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.